Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1050

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së OE "Infinit" SH.P.K. kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje te teknologjisë informative" me numër te prokurimit "612-23-12493-5-5-8 ", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Fushë Kosovë, më 21/03/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e Operatorit ekonomik "Infinit " SH.P.K.", me numër protokolli; 2023/1050, e datës 22/12/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull"Furnizim me pajisje të teknologjisë informative" me numër te prokurimit ;"612-23-12493-5-5-8", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Fushë Kosovë.

2.Vërtetohet, Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues, i datës, 06.12.2023,Kuvendi Komunal Fushë Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën 1.të dispozitivit.

3.Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 06.12.2023 Kuvendi Komunal Fushë Kosove në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pajisje te teknologjisë informative" me numer te prokurimit: "612-23-12493-5-5-8", Ndërsa me datën 06.12.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ka shpërblyer OE "Botek" SH.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 55,550.00 euro.

Me 11.12.2023, OE “Infinit” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 14.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 22.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Infinit” me nr. 1050/23 lidhur me aktivitetin “Furnizim me pajisje te teknologjisë informative” me numër te prokurimit: "612-23-12493-5-5-8".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Në mbështetje te Rregullore 01/2020 e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit gjegjësisht nenit 13 Dorëzimi i Ankesave paragrafi 9 i nenit 13 kërkohet që "Pretendimet ankimore duhet të jenë te njëjta me ato të paraqitura për autoritetin kontraktues".

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Infinit ” SH.P.K.”, janë parashtruar si në vijim:

AK/Komisioni vlersues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ për prokurim publik.AK/zyra e prokurimit me 24.11. ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe letrat standarde per OE ofertues ku eshte rekomanduar per kontrate oferta e kompanise sone si tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet per kete aktivitet te prokurimit.Pas dorezimit te kerkeses per ri-shqyrtim nga OE Botek shpk zyra e prokurimit ka kthyer lenden ne ri-vleresim dhe me 06.12. ka rekomanduar per kontrate OE ankues Botek shpk. Oferta e te cilit ishte e treta me cmimin me te ulet per kete aktivitet te prokurimit Konstatimi i AK/komisionit vleresues per eliminimin e ofertes sone eshte jo-ligjor dhe i pa drejte.

AK/ KK Fushe Kosove pasiqe ka aprovuar pretendimet ankimore te OE Botek shpk ka eliminuar oferten e kompanise sone bazuar ne vendimin e OSHP-se nr. 214/22 me arsyetimin se nuk kemi dorezuar broshurat e produkteve dhe nuk kemi cekur brendin e ofruar.Ky konstatim i AK/komisionit vleresues nuk qendron, ne ftesen per oferte te perpiluar nga AK/ KK Fushe Kosove tek pika IV.6 eshte kerkuar te dorezohen dokumentet si ne vijim: IV.6) Formulari i Tenderit dhe numri i ekzemplareve të Tenderit dhe Lista e Dokumenteve të kërkuara;Tenderi do të përbëhet nga dokumentet e plotësuara dhe të nënshkruara si në vijim:

a. Formulari i Dorëzimit të Tenderit që gjendet në Pjesën B të FPO-së;

b. Deklarata mbi Specifikimet Teknike të objektit të ofruar të kontratës, që korrespondon me ato të përmendura në Aneksin 1 të FPO-së.

c. Siguria e Tenderit, nëse zbatohet; dhe

d. [specifiko ndonjë Dokumente tjera të nevojshme].

Tri kerkesat e lartecekura kompania jone ka dorezuar/plotesuar, tek pika d autoriteti kontraktues nuk ka specifikuar/kerkuar ndonje dokument shtese.Poashtu ne nenin VI.2) te FPO-se/ Vlersimi tenderit eshte cekur Tenderët e pranuar me kohë do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në bazë të kërkesave të parashtruara në këtë FPO. Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur është në përputhje me të gjitha kërkesat e kësaj FPO.

Bazuar ne dispozitat ligjore te ligjit per prokurim publik ne fuqi, neni 52.3/ 56.3 dhe 59.4 AK i ndalohet qe gjate vleresimit te ofertav te perdore kritere jo te matshme te cilat me pare nuk jane specifikuar/ percaktuar ne njoftimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit ne kete rast ne Ftese per ofertim.Citoj nenin 52.3 te LPP-se Neni 52.Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës3. Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kritere të tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistenca teknike.

Citoj nenin 56.3 te LPP-se Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave 3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.Citoj nenin 59.4 te LPP-se 4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.AK ne vendim i referohet vendimit te OSHP-se nr. 214/22 i cili eshte nxjere me 20.06.2022. dhe nuk mund te paralelizohet dhe krahasohet me kete kontrate e cila eshte nenshkruar ne AQP me 30.10.2023. dhe ka terme te ndryshme nga kontrata e cila ka qene ne fuqi deri me 30.08.2023. ne baze te ciles eshte nxjere dhe ka qene baze per shqrtim lenda nr. 214/22.Kushtet e kontrates e cila ka qene ne fuqi kur eshte nxjere vendimi i lartecekur kane qene te ndryshme nga kriteret/kerkesat e parashtruara ne ftesen per ofertim.

Vlerësimi i eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1050, të pretendimeve ankimore të OE "Infinit" Sh.P.K." ankues, si në vijim;

Pretendimet ankimore: Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te bëjë me vlerësimin e ofertave nga AK-ja eksperti shqyrtues sqaron se AK ka aplikuar ftesë për ofertim në bazë të kontratës kornizë të cilën e ka nënshkruar AQP me nr. UA/2016-23-6106-111/C403-C420 në të cilën është pjesë edhe AK- Komuna Fushe Kosovë. Duke u bazuar ne specifikimin teknik pjesë e kësaj kontrate është dërguar edhe kërkesa për furnizim me pajisje e cila është e ngarkuar ne sistemin e epokurimit. Duke administruar provat: FPO, kontratën bazë të AQP-se, vlerësimin e komisionit, kërkesat për rishqyrtim dhe Aneksin 1 specifikimet teknike eksperti shqyrtues sa i përket pjesës ku OE ankues i referohet se nuk janë respektuar kriteret e vendosura ne FPO vlerëson se gjatë fazës se kualifikimit te OE të cilën procedurë e ka zhvilluar AQP janë kualifikuar te gjithë OE të cilët i kanë përmbushur kriteret Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare dhe Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale prandaj pretendimi se nuk janë respektuar kriteret nuk qëndron sepse kualifikimi i OE është bërë ne fazën e parë nga AQP.

Sipas nenit 1.2 të kontratës bazë "Kjo marrëveshje publike kornizë në vetvete nuk është një kontratë, por përcakton termet dhe kushtet për kontratat ndihmëse". Kjo është në përputhje me nenin 54.22 a), b), c) te RRPP 001/2022Çdo FPO do të realizohet në bazë të nenit 4.2, 4.3 te Kontratës bazë.Eksperti shqyrtues sqaron poashtu se në kontratën bazë te specifikimet teknike është kërkuar:"Shënim: Te plotësohen me saktësi dhe qartësi kolonat në të djathtë "specifikacioni teknik minimal i ofruar " dhe secila informata duhet te përputhet me katalogun te cilin e ofroni. Pra gjithsecila informate e plotësuar nga ju duhet te jete edhe ne katalog qe te mund te vërtetohet gjate vlerësimit.

- Për secilin produkt duhet te specifikoni emrin e modelit qe e ofertoni. Ne kolonën e parë te secilit produkt tek – Prodhuesi – Brand name -, duhet te shkruani emrin e modelit duke përfshirë emrin e prodhuesit dhe emrin e sakte te modelit te cilin e ofertoni".Pra sipas ekspertit shqyrtues oferta e OE ankues nuk i plotëson kërkesat e kontratës bazë dhe specifikimet e FPO duke pas parasysh se në ofertë nuk është dorëzuar specifikimi teknik sipas kërkesave te dhëna ne listën e çmimeve por vetëm është plotësuar çmimorja duke mos e qartësuar se cili "brand" është ofruar me ofertë.

Bazuar ne RRUOPP neni 10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së.Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu ("specifikimit teknik"– AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzoj specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara.Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm – ne përputhje me nenin 28 te LPP-se.Prandaj bazuar ne sqarimet e mësipërme eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues ne këtë pikë nuk është i bazuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 05.01.2024 ka autorizuar eksperten shqyrtuese për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1050/23, ndërsa me datë 10.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertes shqyrtuese me nr. 2023/1050 me rekomandimet si në vijim . Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, ndërsa OE ka deklaruar se Nuk Pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtuese.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë Raportit të ekspertit shqyrtues, sipas të cilit pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, janë vlerësuar si të pa bazuara.

Paneli Shqyrtues bazuar në të gjeturat e ekspertit shqyrtues, konsideron se ankuesi nuk ka arritur të dëshmoj me prova konkrete se ka pasur shkelje ligjore nga ana e Autoritetit Kontraktues gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit në fjalë. Andaj Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull"Furnizim me pajisje të teknologjisë informative" me numër te prokurimit ;"612-23-12493-5-5-8", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Fushë Kosovë. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të refuzuar ankesën e Operatorit Ekonomik "Infinit " SH.P.K.", dhe ka Vërtetuar Vendimin e AK -B58 të datës 06.12.2023, Autoritetit Kontraktues, Komuna F.KosovëFerizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur që Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Kuvendi Komunal Fushë Kosovë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pajisje te teknologjise informative" me nr. të prokurimit: "612-23-12493-5-5-8" të mbetet në fuqi.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankese të OE, vendosi të konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË**
- OE - **" INFINITT " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: